

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**, Kolegji për të mitur i përbërë nga gjyqtarët: Hashim Çollaku, kryetar, Rasim Rasimi dhe Gani Zabeli, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Balaj,- procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit H.M. nga f.sh., K. Skenderaj për shkak të veprës penale shtrëngimi nga neni 195 par 2 pika 2.4, lidhur me par. 1 të KPRK-së, dhe veprës penale degradimi i integritetit seksual nga neni 233 par 2 pika 2.1 lidhur me parag. 1 të KPRK, duke vendosur përkitazi me ankesën e përfaqësueses së të dëmtuarës J.K., av. K.A., përfaqësueses së të dëmtuarës S.Zh. av. H.A., ankesën dhe përgjigjen në ankesë të mbrojtësit të akuzuarit av. N.R., të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, PM.nr.143/2016, të datës 09.12.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 16.05.2017, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

Refuzohen si të pa bazuara ankesat e përfaqësueseve të palëve të dëmtuara av. K.A. dhe av. H.H., dhe ankesa e mbrojtësit të akuzuarit av. N.R., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, PM.nr.143/2016, të datës 09.12.2016, vërtetohet.

### A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktgjykimin PM.nr.143/2016, të datës 09.12.2016, të akuzuarin H.M., e ka shpallur fajtor për veprën penale shtrëngimi nga neni 195 par 2 pika 2.4, lidhur me par. 1 të KPRK-së, dhe veprës penale degradimi i integritetit seksual nga neni 233 par 2 pika 2.1 lidhur me parag. 1 të KPRK, dhe për veprën penale nën I të dispozitivit e ka gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 3(tre) muajve, kurse për veprën penale nën II të dispozitivit e ka gjykuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 6( gjashtë) muajve. Me aplikimin e dispozitës së nenit 80 të KPRK-së, e ka gjykuar me dënim unik burgimi në kohëzgjatje prej 8( tetë) muajve , në dënimin e shqiptuar i ka llogaritur edhe kohën e kaluar në paraburgim prej datës 23.04.2016 deri me 06.12.2016.

E ka obliguar të akuzuarin që të paguajë paushallin gjyqësor në shumën prej 50 €, në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të dëmtuarat J.K. S.Zh. për realizimin e kërkesës pasurore juridike i ka udhëzuar në kontest civil

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë kanë ushtruar: Përfaqësuesja e palës së dëmtuar J.K. av. K.A., për shkak të vendimit mbi dënimin, me propozim që ankesa të aprovohet, kurse aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, ashtu që të akuzuarit t'i shqiptojë një dënim meritor, bazuar në rrethanat rënduese të kryerjes së veprës penale dhe qëllimit të dënimit.

Përfaqësuesja e palës së dëmtuar S.Zh. av. H.H., për shkak të vendimit mbi dënimin, me propozim që ankesa të aprovohet, kurse aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, ashtu që të akuzuarit t'i shqiptojë një dënim meritor, bazuar në rrethanat rënduese të kryerjes së veprës penale dhe qëllimit të dënimit.

Mbrojtësi i të akuzuarit av. N.R., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së Ligjit penal dhe vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar kurse aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Përgjigje në ankesën e përfaqësueseve të palëve të dëmtuara ka paraqitur mbrojtësi i të akuzuarit av. N.R. , me propozim që ankesa e Prokurorit të refuzohet si e pabazuar.

Prokurori i Apelit me parashtresën PPAM/I nr.29/17 të datës 07.04.2017, ka propozuar që ankesa e përfaqësueses së palës së dëmtuar të aprovohet si e bazuar, ashtu që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarit t'i shqiptohet një dënim më i lartë, kurse ankesa e mbrojtësit të akuzuarit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata e Apelit mbajti seancën e kolegjit në mbështetje të dispozitave të nenit 390 të KPPK, për të cilën janë ftuar Prokurori i Apelit, i akuzuari, mbrojtësi i tij, përfaqësueset e të palëve të dëmtuara dhe të dëmtuarat. Në seancën e kolegjit morën pjesë: përfaqësueset e të dëmtuarave av. K.A. dhe H.H., i akuzuari H.M. dhe mbrojtësi i tij av. N.R., kurse Prokurori i Apelit dhe të dëmtuarat nuk morën pjesë edhe pse të njoftuara me rregull. Përfaqësuesja e të dëmtuarës J.K. dhe përfaqësuesja e të dëmtuarës S.Zh. pasi që sqaruan disa nga pretendimet ankimore kanë mbetur në tërësi pranë propozimeve të bëra në ankesë. Mbrojtësi i të akuzuarit H.M. av. N.R., pasi që sqaroi disa nga pretendimet si në ankesën me shkrim i ka propozuar kolegjit të Gjykatës së Apelit që ankesën ta aprovoi si të bazuar ndërsa aktgjykimin e ankimuar ta anuloi dhe i njëjti ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendosje. I akuzuari H.M. ,ka mbetur pranë ankesës së ushtruar me shkrim dhe e ka mbështetur fjalën e mbrojtësit të tij.

Gjykata e Apelit pasi që i shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështjeje juridiko-penale, studioi aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPPK dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë gjeti se:

Ankesat janë të pa bazuara.

Në ankesën e mbrojtësit të akuzuarit përkitazi me shkeljet esenciale pretendohet se aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje esenciale, në aktgjykim nuk paraqitet qartë dhe në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh konsiderohet të vërtetuara apo të pa vërtetuara, përkatësisht përfundimisht kishin

për të konstatuar se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet. Dispozitivi i aktgjykimit është në kundërshtim me arsyetimin dhe kundërthënës me vetë vetën, këto mungesa të aktgjykimit paraqesin shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 1 nën par 1.8, Aktgjykimi bazohet në provë të papranueshme, dhe par 2 nën par 2.1 nuk ka zbatuar ndonjë dispozite të këtij kodi ose kanë zbatuar gabimisht të KPPK. Gjykata e bazon aktgjykimin në provë të papranueshme sepse nuk është vërtetuar se Hasani ka kryer asnjërën nga veprat penale të cilat i janë vënë në barrë nga prokuroria dhe për cilat e ka dënuar gjykata. Në ankesën e mbrojtësit pretendohet se të dëmtuarat i kanë dërguar të akuzuarit fotot me dëshirën e tyre, dhe në rastin konkret nuk është argumentuar me asnjë dëshmi konkrete se i akuzuari ka cytur ndonjë nga të dëmtuarat që të ekspozojë pjesët intime të trupit pa pëlqimin e tyre dhe në asnjë mënyrë me kanosje serioze apo kanosje për përdorimin e dhunës, sepse cilado nga të dëmtuarat ka mundur që të mbyll faqen e facebook-ut dhe mos të komunikoj me Hasanin sikur mos të ishte me dëshirë. Gjithashtu sa i përket veprës penale të shtrëngimit nuk përmbushen elementet e kësaj vepre penale në asnjë mënyrë dhe se nuk vërtetohet me asnjë mënyrë që ka pasur kanosje serioze ndaj asnjërës nga vajzat me të cilat ka komunikuar Hasani.

Gjykata e Apelit gjen se pretendimet e mësipërme ankimore përkitazi me këtë bazë nuk qëndrojnë, ngase aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të pretenduara e as që ka shkelje të tjera të cilat kjo gjykatë i vëren sipas detyrës zyrtare, e të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij. Dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është i qartë, nuk përmban kundërthënje qoftë me vetveten ose me arsyetimin e tij . Në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar janë dhënë arsye të duhura faktike dhe juridike të cilat i aprovon edhe kjo gjykatë . Gjykata e shkallës së parë, i vënë në dukje se cilat fakte dhe për çfarë arsye i merre si të provuara ose si të paprovuara dhe njëkohësisht ka bërë vlerësimin e provave kontradiktore. Gjykata e shkallës së parë ka bërë vlerësimin dhe analizën e të gjitha provave të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësorë, duke i paraqitur përfundimet e veta të cilat si të drejta dhe të ligjshme i aprovon edhe kjo gjykatë. Provat e administruara, deklaratat e të dëmtuarave J.K., S.Zh., dëshmia e dëshmitares A.Zh. ,me të cilat gjykata e ka vërtetuar gjendjen e fakteve janë prova të pranueshme dhe me këto prova dhe provat materiale është vërtetuar se i akuzuari H.M. i ka kryer veprat penale për të cilat është shpallur fajtor.

Përkitazi me bazën ankimore shkelja e Ligjit penal, në ankesën e mbrojtësit pretendohet se gjykata ka bërë shkeljen e dispozitës së nenit 385 par 1 nën par 1.2 dhe 1.3 të KPP, me q, rast në situatën konkrete janë plotësuar këto dy dispozita, “Ekzistojnë rrethana që e përjashtojnë përgjegjësinë penale “dhe ekzistojnë rrethana që e përjashtojnë ndjekjen penale. I akuzuari gjatë marrjes në pyetje në prokurori ka deklaruar se nuk i ka kryer veprat penale me të cilat e ngarkon prokuroria. Fakti se ka komunikuar përmes rrjetit social Facebook me dy vajzat e mitura nuk përbën automatikisht vepër penale.

Me vërtetimin e drejtë të gjendjes së fakteve, gjykata e shkallës së parë drejtë e ka zbatuar edhe të drejtën materiale, kur ka gjetur se në veprimet e të akuzuarit H.M. formohen të gjitha elementet qenësore objektive dhe subjektive të veprave penale degradimi i integritetit seksual nga neni 233 par 2 pika 2.1 lidhur

me par 1 të KPRK dhe veprës penale shtrëngimi nga neni 195 par 2 pika 2.4 lidhur me par 1 të KPRK.

Në ankesën e përfaqësueses të palës së dëmtuar J.K. av. K.A., përkitazi me vendimin mbi dënimin pretendohet se gjykata e shkallës së parë, edhe përkundër faktit se në mënyrë të drejtë e ka vërtetuar gjendjen faktike në këtë çështje penale, sa i takon sanksionit penal ndaj të akuzuarit H.M. konsiderojmë se dënimi është i ulët krahas peshës së veprës penale dhe rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, sepse i akuzuari veprën penale e ka kryer me dashje dhe me paramendim ,andaj nuk do të duhej që ti shqiptohej dënimi minimal i paraparë në KPRK. I akuzuari nuk e ka pranuar fajësinë dhe as nuk është penduar për veprimet e tij, prandaj për bindjen tonë, nuk është e mjaftueshme e as e drejte të caktoj dënimin minimal dhe të bazohet vetën në rrethanat lehtësuese, dhe të bëjë neglizhimin e rrethanave rënduese për të akuzuarin.

Në ankesën e përfaqësueses së të dëmtuarës S.Zh. av. H.A. theksohet se gjykata e shkallës së parë me rastin e marrjes së vendimit mbi caktimin e llojit dhe të lartësisë së dënimin, nuk muerr parasysh fare asnjë rrethanë rënduese por vetëm ato rrethana lehtësuese, të cilat kanë ndikuar në llojin dhe lartësinë e dënimin konform nenit 73 të KPRK. Është dashtë ti ketë parasysh rrethanat rënduese, shkallën e përgjegjësisë penale, motivet nga të cilat është kryer vepra penale, intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur, ngase kemi të bëjmë me dy vajza të mitura që i është dëmtuar dinjiteti dhe morali në shkallë të lartë.

Përkitazi me dënimin e shqiptuar ndaj të akuzuarit mbrojtësi në ankesë thekson se dënimi të cilin ia ka shqiptuar gjykata të akuzuarit ishte vetëm sa për të arsyetuar kohen e kaluar në paraburgim sepse me asnjë provë nuk është vërtetuar se i akuzuari është fajtor.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, duke i shqyrtuar ankesat përkitazi me vendimin mbi dënimin të njëjtat i ka refuzuar si të pabazuara.

Gjykata e shkallës së parë, me rastin e matjes së dënimin i ka marrë parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimin në pajtim me nenin 73 të KPK, ku si rrethana lehtësuese gjykata ka vlerësuar se i akuzuari kishte sjellje korrekte në gjykatë, se është i moshës së re, më parë nuk ka qenë i dënuar andaj i ka shqiptuar dënimin si në dispozitivin e aktgjykimit me bindje se ky dënim i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë penale të akuzuarit, intensitetit të rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur dhe me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimin.

Vlerësimin e këtyre të rrethanave relevante për matjen e dënimin e pranon edhe kjo gjykatë, e meqë në ankesën e përfaqësueseve të palëve të dëmtuara nuk pati ndonjë rrethanë konkrete rënduese që kishte me ndikuar në ashpërsimin e dënimin si dhe disa prej rrethanave të cekura në ankesa nuk mund të merren si rrethana rënduese sepse paraqesin elemente të veprës penale e duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat të cilat i ka konstatuar gjykata e shkallës së parë, edhe kolegji i Gjykatës së Apelit vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit nga ana e gjykatës së shkallës së parë është në harmoni me intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur dhe shkallën e përgjegjësisë

penale të akuzuarit si ekzekutor dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i parashikuar me dispozitën e nenit 41 të KPRK-së, ku do të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Nga kjo që u tha më lartë, e në bazë të nenit 401 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**PAKR.165/2017, me dt. 16.05.2017.**

**Bashkpunëtori profesioal,**

**Bujar Balaj**

**Anëtarët e kolegjit**

**Kryetari i kolegjit.**

**Rasim Rasimi**

**Hashim Çollaku**

**Gani Zabeli**